



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 33.2, shkronja a, dhe të nenit 34.1, shkronja d, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.08.2018, miratoi këtë

**V E N D I M**

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Feti (Halil) Selmani, Haki (Halil) Selmani dhe Ismajl Abazi.
- II. Sipas propozimit të cekur në pikën I, këmbimi do të nënkuptojë:
  1. Parcelën e paluajtshme në pronësi të Komunës, pjesën e parcelës kadastrale nr. 118-0, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914066-00118-0, me sipërfaqe për këmbim 143 m<sup>2</sup>, ZK Sofali, Prishtinë.
  2. Parcelën e paluajtshme në pronësi të bashkëpronarëve Feti (Halil) Selmani, Haki (Halil) Selmani dhe Ismajl Abazi, për parcelën kadastrale nr. 110-3, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914066-00110-3, me sipërfaqe për këmbim 143 m<sup>2</sup>, ZK Sofali, Prishtinë.
- III. Propozimi për iniciimin e këmbimit të parcelave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë sipas Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore nga Drejtoria e Urbanizmit, nr. 05, nr. 350/02-0051312/18, dt. 24.04.2018, për realizimin e Planit rregullues "Sofalia" në Prishtinë.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private.



- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarëve të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse e këtij propozimi janë shkresat e lëndës.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-463/03-195042/18, më 09.08.2018

**Kryesues i Kuvendit**  
**Agim Kuleta**

